



## VENDIM

Nr. 389, datë 3.5.2017

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR  
KALIMIN E KONTRATËS SË QIRASË NR.  
455 REGJ., NR. 151 PROT., DATË 5.5.2014,  
NË KONTRATË ME TARIFËN  
1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET  
MINISTRISË SË ZHVILLIMIT  
EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË  
DHE SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS,  
DHE SHOQËRISË “ARDIT”, SH.P.K., SI  
QIRAMARRËS, PËR PASURINË “DEPO  
TË SHEQERIT, DEPO TË BËRSIVE,  
REPART AMBALAZHI, DEPO DHE  
SIPËRFAQE FUNKSIONALE”, TË  
SHOQËRISË “KOMBINATI I  
SHEQERIT”, SH.A., MALIQ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për kalimin e kontratës së qirasë nr. 455 regj., nr. 151 prot., datë 5.5.2014, në kontratë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë “ARDIT”, sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Depo të sheqerit, depo të bërsive, repart ambalazhi, depo dhe sipërfaqe funksionale”, në administrim të shoqërisë “Kombinati i Sheqerit”, sh.a., Maliq, me sipërfaqe të përgjithshme 5 773 (pesë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre) m<sup>2</sup>, sipas genplanit, nga e cila, 3 133 (tre mijë e njëqind e tridhjetë e tre) m<sup>2</sup> sipërfaqe nën objekt dhe 2 640 (dymijë e gjashtëqind e dyzet) m<sup>2</sup> sipërfaqe funksionale, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe shoqëria “Kombinati i Sheqerit”, sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
**Niko Peleshi**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ZYRA E NOTERISË TIRANË**

Nr. \_\_\_\_\_ Rep.

Nr. \_\_\_\_\_ Kol.

**DRAFT ANEKS KONTRATE QIRAJE  
(me tarifën simbolike 1euro/kontrata)  
lidhur**

Në Tiranë, sot me datë \_\_\_\_\_ të muajit \_\_\_\_\_ të vitit 2017 (dymijë e shtatëmbëdhjetë), u paraqiten para meje noterit \_\_\_\_\_, palët kontraktuese si më poshtë vijon:

**Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes**, përfaqësuar nga Z. \_\_\_\_\_, i pajisur me letërnjoftimin nr. \_\_\_\_\_, me detyrë \_\_\_\_\_ në këtë Ministri, në bazë të autorizimit të Ministrit, nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, që më poshtë do të quhet **“QIRADHËNËSI”**

**Dhe**

**Shoqëria “ARDIT” SHPK** me seli në Korçë, Libonik, me adrese: Drithas, Libonik, Korçë e regjistruar si person juridik dhe pajisur nga QKB me NIPT: K04005074J, përfaqësuar nga administratori i shoqërisë Z. Festim Lami, i lindur më \_\_\_\_\_, banues në \_\_\_\_\_ i pajisur me letër njoftimin nr. \_\_\_\_\_, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që më poshtë do të quhet **“QIRAMARRËSI”**

**Të cilët deklaruan se:**

- Mbështetur në Vendimin Nr. 590, datë 01.07.2015 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në vendimin nr.41, datë 12.08.1999 të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin e së drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte, pronë publike, organeve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe një ndryshim të vendimit nr.127, datë 2.02.2009, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Maliq, të Qarkut Korçë”, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në cilësinë e “Qiradhënësit”
- Mbështetur në Vendimin Nr.54, datë 05.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”, të ndryshuar,
- si dhe në zbatim të Vendimit Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.2017 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien e miratimit për kalimin e kontratës së qirasë nr.455 regj., nr.151 prot., datë 05.05.2014, në kontratë qiraje me tarifën simbolike 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënësi, dhe shoqërisë “ARDIT” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Depo të sheqerit, depo të bërësive, repart ambalazhi, depo dhe sipërfaqe funksionale”, të shoqërisë “Kombinatit të Sheqerit” SHA”,
- dhe bazuar në nenet 801-825 të Kodit Civil,

me kërkesë të shoqërisë qiramarrëse “ARDIT” sh.p.k. si “Qiramarrës”, palët bien dakord që në kontratën e qirasë nr.455 regj., nr.151 prot., datë 05.05.2014, për objektet “Depo të sheqerit, depo të bërësive, repart ambalazhi, depo dhe sipërfaqe funksionale”, njësi në administrim të “Kombinati i Sheqerit” SHA, Maliq, të bëhen ndryshimet si vijojnë:



1. Pika 5.4, në nenin 5, ndryshohet si më poshtë:

“5.4 “Qiramarrësi” detyrohet që në pasurinë e marrë me qira të ketë të punësuar jo me pak se 50 vetë.”

2. Në nenin 5, shtohet pika 5.10 me përmbajtje si më poshtë:

“5.10 “Qiramarrësi” detyrohet të paraqesë tek “Qiradhënësi” kopje të noterizuar të autorizimit për përpunim aktiv të mallrave lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, sa herë që ai përsëritet, si dhe çdo dokumentacion tjetër ligjor që vërteton kryerjen e aktivitetit të përpunimit aktiv të mallrave.”

3. Pika 6.1, në nenin 6, të kontratës ndryshohet si më poshtë:

“6.1 “Qiramarrësi”, detyrohet t’i paguajë “Qiradhënësit” detyrimin e kontratës, në vlerën 1(një) Euro. Pagesa simbolike bëhet para firmosjes së aneks-kontratës dhe kjo pagesë përfshin vetëm periudhën nga hyrja në fuqi e aneks kontratës deri me përfundim të afatit të kontratës bazë.”

4. Pika 6.3, në nenin 6, të kontratës ndryshohet si më poshtë:

“6.3 Pagesa simbolike bëhet para firmosjes së aneks-kontratës dhe kjo pagesë përfshin vetëm periudhën nga hyrja në fuqi e aneks kontratës deri me përfundim të afatit të kontratës bazë.

5. Ky aneks kontratë shfuqizohet në rastet kur:

- a. Kur “Qiramarrësi” penalizohet dy herë rresht me gjobë për çdo vend pune të pahapur.
- b. Kur “Qiramarrësi”, për një periudhë më shumë se pesë muaj nuk pajiset me autorizim për përpunim aktiv të mallrave.

Në rast se, aneks kontrata shfuqizohet marrëdhëniet midis palëve do të vazhdojnë sipas kontratës së qirasë nr.455 regj., nr.151 prot., datë 05.05.2014.

Kjo aneks-kontratë është pjesë përbërëse e kontratës së qirasë nr.455 regj., nr.151 prot., datë 05.05.2014, për objektet “Depo të sheqerit, depo të bërsive, repart ambalazhi, depo dhe sipërfaqe funksionale”, njësi në administrim të “Kombinati i Sheqerit” SHA, Maliq dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Aneks kontrata është formuluar në gjashtë kopje origjinale dhe pasi ju lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe pranuan, e nënshkruan atë para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë dhe unë noter \_\_\_\_\_, në bazë të nenit 801 e vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë rregullisht.

**QIRADHËNËSI**

**Ministria e Zhvillimit Ekonomik,  
Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes**

**Përfaqësuar nga**

**QIRAMARRËSI**

**Shoqëria “ARDIT” sh.p.k.**

**Përfaqësuar nga**

**Festim Lami**